

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

**PROGRAMI I LËNDËS
SË GJUHËS SHQIPE
KLASA VII**

Tiranë, 2005

I. HYRJE

Mësimi i gjuhës shqipe në shkollë përbën lëndën bazë në sistemin e edukimit parauniversitar dhe duhet vlerësuar si momenti kyç i tërë suksesit dhe i progresit të nxënësve. Nëpërmjet tij hidhen bazat për zhvillimin intelektual, emocional e shoqëror të nxënësit, duke mundësuar realizimin e komunikimit për qëllime të ndryshme, duke zbuluar përvojat, ndjenjat dhe idetë e tyre dhe të tjerëve, duke i dhënë kuptim të menduarit.

Gjuha që mësojnë dhe fitojnë nxënësit në shkollë, është pasqyrë e formimit si individ dhe karakteristikë e të folurit të tyre. Nxitja për të pasuruar përvojat gjuhësore, për t'i bërë ato më të pasura, më të këndshme dhe më të larmishme është detyrë me rëndësi e shkollës dhe e mësuesit.

Në vështrim të përgjithshëm, shkolla ka për detyrë të mbështesë nxënësit për të mësuarit e gjuhës amtare shqipe në formën e vet standarde.

Kështu, nëpërmjet lëndës së gjuhës shqipe zhvillohen dhe arrihen dy objektiva të rëndësishëm mësimorë:

- *Zhvillohen shprehje komunikuese, të cilat realizojnë në tërësi aktin e komunikimit: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit.*
- *Jepen dhe sistemohen njohuri të caktuara për gjuhën shqipe, sistemin e saj gjuhësor, si dhe për normën standarde të gjuhës shqipe;*

II. SYNIMI I LËNDËS

Mësimi i gjuhës amtare në nivelin e mesëm të ulët, nisur nga objekti i vet si lëndë parësore e karakter të theksuar kombëtar, synon zhvillimin e përgjithshëm intelektual dhe komunikues të çdo individi, realizimin e të gjitha marrëdhënieve komunikuese në shoqëri. Ato realizohen përmes gjuhës dhe formimit të individit me shprehje të plota dhe të qarta gjuhësore që do ta aftësojnë për ta përdorur gjuhën në nivel të pranueshëm nga të tjerët gjatë të folurit, të lexuarit e të shkruarit.

III. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM TË MËSIMIT TË GJUHËS SHQIPE NË KLASËN VII

Mbështetur në formulimin e mësipërm, mësimi i gjuhës shqipe në klasën e shtatë synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

- *T'i aftësojë nxënësit për të komunikuar për qëllime të ndryshme, duke i dhënë kuptim të menduarit të tyre nëpërmjet të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.*
- *T'i aftësojë nxënësit të përvetësojnë gjuhën amtare në atë nivel e cilësi, që të mundësojë të mësuarit e tyre në vazhdimësi për tërë jetën, duke shprehur përvoja gjuhësore të pasura, të këndshme, të larmishme, si dhe duke shprehur imagjinatën dhe ndjenjat e veta rreth dukurive të jetës dhe të botës që i rrethon, në marrëdhënie të tilla, si: dialogu, mirëkuptimi, loja e bashkëpunimi.*

- *Të mundësojë rritjen dhe zhvillimin individual, emocional, estetik, shoqëror dhe moral të çdo nxënësi.*
- *Të njohë dhe të analizojë sistemin gjuhësor të shqipes në nivelet e veta përfaqësuese: drejtshqiptim, drejtshkrim, fjalëformim, morfosintaksë etj.*
- *Të zhvillojë imagjinatën dhe ndjenjat rreth dukurive të jetës dhe botës që i rrethon.*
- *Të zhvillojë mendimin e pavarur dhe kritik të nxënësve.*
- *Të zhvillojë ndjenjën e identitetit kombëtar dhe kulturor.*
- *Të zhvillojë një formim tërësor të nxënësve rreth dukurive dhe problemeve të sotme të shoqërisë njerëzore.*

IV. FUSHAT E STUDI MIT

Linjat dhe nënlinjat:

- *Të dëgjuarit*
- *Të folurit*
- *Të lexuarit*
- *Të shkruarit*
- *Njohuri rreth sistemit të gjuhës*

V. STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

35 javë mësimi me 5 orë mësimi në javë = 175 orë gjithsej

	Linja	Orë	Nënlinja	Orë
1.	Gjuhë e folur	14	Gjuhë e folur	14
2.	Lexim	75	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Letërsi shqipe dhe e huaj ▪ Përralla ▪ Tregime ▪ Fabula ▪ Vjersha ▪ Folklor 	75
3.	Gjuhë e shkruar	16	Gjuhë e shkruar	16
4.	Njohuri rreth gjuhës	60	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Sintaksë ▪ Morfologji ▪ Leksikologji ▪ Kulturë gjuhe ▪ Drejtshkrim 	21 21 6 3 9
5.	Dispozicion	10	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Diktme ▪ Përsëritje ▪ Testime 	10

VI. ZBËRTHIMI I PËRMBAJTJES SË PROGRAMIT SIPAS LINJAVE, NËNLINJAVE, OBJEKTIVAVE DHE ARRITJEVE

LINJA: Të dëgjuarit dhe të folurit (14 orë)

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat	Arritjet e pritshme
1. Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime 3 orë	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Punohen materiale të ndryshme të shkruara për qëllime të ndryshme, që japin informacion dhe nxisin diskutime nga fusha të ndryshme të veprimtarisë. ☞ Materiale të ndryshme: gazeta, revista, lexime nga libra me karakter kryesisht joletrar, guida, fletëpalosje, harta etj. ☞ Ngrihen situata dhe çështje të ndryshme studimore për tema të caktuara për të cilat nxënësve u duhet të flasin. ☞ Tema të mundshme orientimi në treg, stacionin e trenit, në aeroport, në mjedise publike, sportive, ekspozita, biblioteka, koncerte etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të ndjekë me vëmendje bashkëbiseduesin ose informacionin që vjen nga burime të ndryshme TV, radio, video etj. • Të tregojë respekt dhe interes gjatë bashkëbisedimeve. • Të interpretojë informacionin e marrë duke e shoqëruar edhe me informacion shtesë që mund ta ketë vetë nxënësi. • Të japë këshilla të nevojshme, duke i plotësuar dhe duke i pasuruar më tej këshillat e të tjerëve etj. • Të bëjë komente rreth këshillave që ka lexuar më parë dhe të mbajë qëndrime në rast e ato nuk janë të qarta dhe të përshtatshme. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndjek me vëmendje e informacionin që vjen nga burime të ndryshme. ▪ Shkëmben dhe interpreton informacion nga fusha të ndryshme të veprimtarisë. ▪ Interpretin informacion të marrë nga burime të ndryshme duke sjellë edhe fakte dhe vlerësime të reja. ▪ Jep këshilla, udhëzime, orientime etj. ▪ Komenton dhe mban qëndrime rreth këshillave që i jepen.
2. Të dëgjuarit dhe të folurit në grup 3 orë	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Situata të ndryshme me tematikë nga veprimtaria e përditshme dhe me tema të tjera të rëndësishme që kërkojnë gjithëpërfshirjen e nxënësve dhe nxisin të folurit në grupe të vogla dhe të mëdha 	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshtasë të folurit e vet për situata reale komunikimi në grup. • Të jetë aktiv për të folur në grup për tema që i interesojnë ose jo. • Të vlerësojë të folurit e të tjerëve në situata grupi. • Të ndalojë në çështje që lidhen me 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Ndjek dhe respekton pjesëtarët e grupit. ▪ Veçon çështje që lidhen me temën për të cilën diskutohet, dhe i përdor ato si argumente të mëtejshme. ▪ Gjen dhe propozon alternativa kur

	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Punohet me tema që lidhen me punët e përbashkëta, projektet, përgjegjësitë e grupit, të folurit në publik. ☞ Të marrë nisëtiava për të folur në rolin e një komentatori, politikani, paraqitësi, biznesmeni etj. 	<p>temën që diskutohet, duke hapur debat ose diskutim të mëtejshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të japë mendime alternative. • Të përdorë gjuhë të përshtatshme dhe me terminologji të zgjedhur. • Të ndryshojë linjën e argumenteve duke i pasuruar më tej ato. • Të respektojë pikat kyç të diskutimit në grup. 	<p>i kërkohen.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Përdor gjuhë të përshtatshme dhe me terminologji të zgjedhur. ▪ Ndihmon në ndryshimin e linjës së argumenteve. ▪ Kërkon dhe gjen pika kyç për të ndihmuar gjatë diskutimit në grup.
<p>3. Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme</p> <p style="text-align: center;">3 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Krijohen situata reale komunikimi që kanë të bëjnë me përvoja të ndryshme, me ndjenja dhe mendime të shprehura për çështje të ndryshme, të cilat zgjidhen nga leximet dhe përvojat vetjake. ☞ Zakonisht punohet me tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, duke i vlerësuar ato për strukturën, përmbajtjen dhe elemente të tjera që lidhen me ndërtimin e tyre dhe me përmbajtjen. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të shprehë përvoja vetjake për probleme të ndryshme. • Të shfaqin mendime rreth përvojave të shprehura prej të tjerëve. • Të shprehin ndjenjë dhe emocion gjatë të treguarit. • Të organizojë diskutimin duke i vendosur idetë qartë dhe kuptueshëm. • Të përdorin pyetjet: <i>Kush?, kur?, ku?, si?, sa?</i> kur dikuton për t'u bërë më bashkëpunues në grup. • Të tregojë dhe të pyesë për detaje shtesë. • Të bëjë hyrje, zhvillime, mbyllje të përvojave që tregon. • Të shoqërojë të folurit e tyre me gjeste verbale dhe joverbale. • Të ndihmojë në situata për zgjidhje konflikti. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përcjell përvoja vetjake për probleme e tema që diskutohen. ▪ Jep mendime dhe vlerësime rreth përvojave të shprehura prej të tjerëve. ▪ Shpreh me ndjenjë dhe emocion ide që lidhen me çështje të rëndësishme të teksteve që ka lexuar. ▪ Shpreh ide, fakte, argumente për mënyrën si duhet të organizojë diskutimin për tekste të ndryshme. ▪ Përdor me vend duke pasuruar të folurit e tij me pyetjet: <i>Kush?, kur?, ku?, si?, sa?</i> ▪ Pyet dhe përgjigjet për detaje shtesë. ▪ Krijon dhe formulon qartë <i>hyrje, zhvillime e mbyllje</i> për tregime dhe përvoja vetjake dhe të të

			<p>tjerëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shoqëron të folurit më gjeste verbale dhe joverbale ▪ Mban qëndrim, vlerëson dhe jep ndihmesë në situata mosmarrëveshesh.
<p>4. Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe të gjinive letrare</p> <p style="text-align: right;">3 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Tekste të ndryshme letrare dhe joletrare në të cilat analizohen: struktura, elementet e saj dhe tregues të tjerë formalë. ☞ Tekste të llojeve të ndryshme për të bërë sa më shumë krahasime. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojë në histori të ndryshme elementet formalë dhe gjuhësorë që i dallojnë ato nga llojet e tjera. • Të krahasojë poezinë me prozën. • Të krahasojë elementet gjuhësore që përcaktojnë struktura të teksteve të tipit: <i>intervistë, reportazh, skicë, raport, informacion i shkurtër etj.</i> • Të përcaktojë ndryshimet mes skeleteve të ndryshme të teksteve letrare dhe joletrare. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallon elemente formale dhe gjuhësore në tekste të ndryshme. ▪ Njih struktura të teksteve të tipit: <i>shënime, ditar, novelë, skicë, raport, referat, përmbledhje etj.</i> ▪ Përcakton ndryshimet ndërmjet skeleteve të teksteve letrare dhe joletrare.
<p>5. Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe</p> <p style="text-align: right;">2 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Diskutohet dhe mbahet qëndrim rreth respektimit të normës së gjuhës shqipe dhe të dialekteve. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të diskutojë rreth standardit të gjuhës shqipe. • Të krahasojë dialektet e gjuhës shqipe. • Të vlerësojë gjuhën e masmedias dhe të teksteve të tipit letrar dhe joletrar. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përdor saktë gjuhën standarde shqipe. ▪ Diskuton rreth dialekteve të shqipes ▪ Vlerëson gjuhën e masmedias dhe të teksteve të tipit letrar dhe joletrar.

LINJA: Të lexuarit (75 orë)

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat	Arritjet e pritshme
<p>1. Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion</p> <p>4 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Përzgjidhen tekste, broshura, libra të vegjël, orare, fletëpalosje, guida. ☞ Ndiqen burime të larmishme informacioni, referenca, bibliografi ☞ Përzgjidhen materiale të shoqëruara me grafikë, matrica, diagrame, ilustrime etj. ☞ Kërkohen dhe punohen <i>Informacione shkencore , revista të karakterit shkencor mediatik që kanë interes për nxënësit e kësaj moshe etj.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë duke treguar interes për të marrë informacionin, duke e shpjeguar atë. • Të lexojë duke ia përshtatur intonacionin llojit të tekstit • Të lexojë duke respektuar shenjat e pikësimit sipas llojit të tekstit etj. • Të vlerësojë tekstet e tipit joformal. • Të lexojë duke shpjeguar grafikët, tabelat, pikturat, ngjyrat dhe shenja të tjera, me të cilat shoqërohen tekstet. • Të lexojë artikuj nga revista dhe botime shkencore për fëmijë me informacione nga fusha të ndryshme të tilla, si: <i>loja, interesat, zbulimet, interneti, shëndetësi, mjedis, sport, barazi gjinore, të drejtat e fëmijëve etj.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lexon me kuptim dhe interpreton tekste të llojeve të ndryshme letrare dhe joletrare. ▪ Marr informacion të vazhdueshëm të natyrave të ndryshme përmes përdorimit të materialeve të ndryshme të shkruara: <i>revista, gazeta, letrësisë artistike, buletine.</i> ▪ Shpjegon dhe interpreton informacionin e marrë. ▪ Lexon duke i shpjeguar hartat, diagramet, figurat, pikturat etj. ▪ Argumenton dhe vlerëson çështje dhe probleme rreth temave të lexuara. ▪ Krahason shkrime informative të tipave të ndryshëm.
<p>2. Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave</p> <p>25 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Tekste të llojit letrar të niveleve cilësore, përfaqësuese të letërsisë shqiptare dhe botërore të kohërave të ndryshme. ☞ Poezi, prozë dramë. ☞ Biografi e shkrimtarëve të njohur 	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë në mënyrë artistike dhe me ndjenjë. • T'i ngallet dashuria për të lexuar letërsi artistike. • Të lexojë duke e përzgjedhur materialin sipas interesave dhe dëshirave të veta. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lexon në mënyrë të pavarur dhe për interesa vetjake. ▪ Vlerëson anët pozitive dhe negative të teksteve të lexuara. ▪ Shpreh dëshirë specifike rreth llojeve e stileve të pjesëve që lexon. ▪ Lexon pjesë të dramatizuara.

<p>3. Të lexuarit për të mbajtur qëndrim për idetë e pjesës dhe figurat letrare</p> <p>20 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Vepra të letërsisë shqiptare dhe të letërsisë botërore të kohërave të ndryshme dhe të përshtashme për këtë moshë. ☞ Paraqitja e figurave bazë letrare: <i>epitet, krahasim, simboli hiperbola.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë tekste të llojeve të ndryshme letrare e jolettrare, si: <i>poezi prozë, dramë, artikuj gazete etj.</i> • Të lexojë me kuptim, qartë dhe me shqiptim të saktë • Të kuptojë nëpërmejet tekstit mesazhet që përcillen në nëntekstin e tij. • Të dallojë figurat letrare gjatë leximit dhe komentimit të pjesëve. • Të kometojë përmes analizave të tekstit fragmente të ndryshme. • Të analizojë personazhet. • Të mbajë qëndrim rreth ideve dhe mesazheve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lexon lloje dhe gjini të ndryshme letrare. ▪ Analizon dhe kometon fragmente të lexuara. ▪ Krahason stile të shkrimtarëve. ▪ Vlerëson karaktere, ngjarje, mosmarrëveshje, marrëdhëniet e brendshme, përmbajtjen. ▪ Vlerëson gjuhën dhe stilin e shkrimtarit. ▪ Dallon figura të thjeshta letrare, si: epiteti, krahasimi, hiperbola, simboli. ▪ Sfaq mendime për veprat e autorëve të ndryshëm.
<p>4. Të lexuarit e llojeve e të gjinive letrare</p> <p>20 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Tekste të tipave të ndryshëm, si: <i>poemë, poezi, dramë, tregim, novelë, roman etj.</i> ☞ Tekste të tipit informativ për të bërë krahasime me tekste të tipit letrar. ☞ Realizimi i detyrave për leximet jashtë klase. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të grupojë pjesët që lexon sipas gjinitë dhe llojeve letrare. • Të shpjegojë ndryshimet mes llojeve dhe gjinive letrare. • Të krahasojë tekstet letrare dhe ato jo letrare. • Të analizojë subjektin dhe përmbajtjen <ul style="list-style-type: none"> - e teksteve të ndryshme. - Të bëjë përmbledhje të shkurtra rreth teksteve që lexon. - Të bëjë përmbledhje të thjeshta për tekste të lexuara për fondin e literaturës së leximeve jashtë klase 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njih dhe krahason gjini dhe lloje letrare, si: <i>prozë, poezi dhe dramë</i>, si dhe jep karakteristikat e tyre. ▪ Nxjerr në pah elemente dalluese të llojeve dhe stileve të mësipërme. ▪ Analizon subjektin dhe përmbajtjen e teksteve të ndryshme. ▪ Komenton ide dhe motive që përcjellin veprat. ▪ Analizon tregues gjuhësorë që u japin shkrimeve vlera artistike, figura të thjeshta letrare, si: epiteti, krahasimi, hiperbola etj.

			<ul style="list-style-type: none"> ▪ Bën përmbledhje të thjeshta lidhur me vepra të ndryshme të dhëna për lexime jashtë klase.
<p>5. Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje</p> <p style="text-align: right;">4 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Pjesë të regjistruara. ☞ Tekste dramatike që janë të mundshme për t'u dramatizuar dhe për t'u luajtur sipas roleve nga nxënësit. ☞ Interpretim i veprave të shquara të letërisë shqipe dhe botërore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë me zë të lartë, saktë dhe me intonacionin e duhur. • Të interpretojë pjesë letrare të llojeve të ndryshme. • Të mësojë përmendësh pjesë në poezi dhe në prozë. • Të interpretojë në grupe të vogla dhe në grupe të mëdha. • Të marrë pjesë në dramatizime të pjesëve të ndryshme. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lexon pjesët me zë të lartë, saktë dhe me intonacionin e duhur. ▪ Interpreton tekste të llojeve të ndryshme me intonacionin e duhur. ▪ Reciton përmendësh pjesë në poezi dhe në prozë. ▪ Dramatizon pjesë të ndryshme. ▪ Interpreton role e monologje sipas pëlqimit dhe zgjedhjes.
<p>6. Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe</p> <p style="text-align: right;">2 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Terma që do t'i shtohen tashmë analizave të nxënësve në lidhje me tekstet që lexojnë, si: tema, karakteret, vendosja e marrëdhënieve, motivet, idetë, plani i pjesës. ☞ Terma të tjera të reja, si: faktet, mendimet, vlerësimi, argumenti. ☞ Figurat letrare që dalin në këtë program për herë të parë: <i>epitet, simbol krahasim, hiperbolë</i>. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të respektojë gjatë të lexuarit rregullat e drejtshqiptimit të strukturave morfologjike. • Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të reja të fushave të veprimtarisë sipas tematikës së dhënë nga pjesët që lexohen. • Të përdorë fjalorë për shpjegimin e fjalëve të vështira dhe të panjohura. • Të krijojë skedarin e librave që lexon. • Të përdorë bibliotekën dhe internetin 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lexon dhe interpreton duke respektuar shenjat e pikësimit dhe të shqiptimit të fjalëve. ▪ Përdor terma të tilla, si: <i>subjekt, strukturë, motiv, mesazh, karakter, personazh, gjini, figurë letrare, koment etj.</i> ▪ Përdor fjalor dhe skeda shpjeguese etj. ▪ Jep vlerësime për mënyrën si janë shkruar veprat letrare, formën dhe gjuhën e përdorur. ▪ Përdor bibliotekën, shpesh edhe internetin.

UDHËZIME

Për leximet këshillohet të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe e huaj në përshtatje me moshën e fëmijëve të klasës së shtatë, të cilat plotësojnë kriteret artistike dhe didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës.

Të përfaqësohen pjesë nga tradita, nga e kaluara dhe e sotmja, pjesë fantastiko-shkencore për të ardhmen përmes raporteve të drejta, ku vendin kryesor ta zënë pjesët që pasqyrojnë të sotmen dhe pjesë që zhvillojnë imagjinatën për të ardhmen.

Këto raporte të përfaqësohen sipas ndrajeve të mëposhtme.

30% pjesë me përmbajtje nga e kaluara.

50% pjesë me përmbajtje nga e sotmja, sidomos nga veprimtaria jetësore dhe pjesë me aventurat e “ bëma ” të fëmijëve e të adoleshentëve në ditët tona, pjesë që lidhen me të drejtat e fëmijëve etj.

20% pjesë që zhvillojnë fantazinë dhe imagjinatën për të ardhmen në fusha të ndryshme të veprimtarisë jetësore të fëmijëve dhe të adoleshentëve në ditët tona: *kozmosi, fantoshkenca, informacioni, mjedisi etj.*

Letërsia shqipe me letërsinë e huaj të përfaqësohen me raportet 70% me 30%.

Njëkohësisht këshillohet që të përfaqësohen në këtë klasë gjini të ndryshme: 75% prozë, 15% poezi, 10% dramë.

Për leximet jashtë klase të mbahen parasysh titujt e autorët e miratuar.

Përsa i përket përfaqësimit të teksteve letrare e teksteve joletrare, të respektohen raportet 80% me 20%.

Brenda leximit të gjejnë trajtim edhe punët me shkrim, të cilat do të përcaktohen përfundimisht në udhëzimin për zbatimin e këtij programi.

Të arrihet që nxënësit të përgatisin edhe detyra me shkrim në formë referati të thjeshtë për lexime jashtë klase, orët e të cilave mësuesi t’ i vendosë në planin e tij kur të bëjë zbërthimin analitik të programit.

Figurat letrare të përfaqësohen përmes simbolit, epitetit, krahasimit e hiperbolës.

LINJA: Të shkruarit (16 orë)

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat	Rezultatet e pritshme
<p>1. Të shkruarit funksional</p> <p>4 orë</p>	<p>☞ Lloje dhe modele shkrimi të shkruarit të tilla, si: <i>njoftime, autoportrete, intervista, shkrime përshkruese a krijuese, porosi, udhëzime, skeda, formate dokumentesh, artikuj për gazeta muri, ese letra, fjalëkryqe, përmbledhje.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë për përvojat e tij. • Të shkruajë për qëllime të ndryshme. • Të shkruajë për një shumëllojshmëri qëllimesh dhe modelesh shkrimi. • Të shkruajë për një gjerësi lexuesish: <i>për mësuesin, për prindërit, për shokët, për gazetën e klasës dhe të shkollës, për komunitetin etj.</i> • Të shkruajë në një shumëllojshmëri modelesh, si: <i>porosi, udhëzime, skeda, formate, dokumente, artikuj për gazeta muri, ese, përmbledhje, shkrime përshkruese a krijuese etj.</i> • Të shkruajë për të mbajtur qëndrime dhe për të dhënë informacione dhe vlerësime përmes <i>eseve argumentuese.</i> 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shpreh përvoja vetjake me shkrim. ▪ Shkruan për qëllime të ndryshme. ▪ Shkruan në një shumëllojshmëri qëllimesh dhe modelesh të shkruarit. ▪ Shkruan për një gjerësi lexuesish, për gazetën e klasës dhe të shkollës, për komunitetin etj. <ul style="list-style-type: none"> • Shkruan shkrime të tipit: <i>porosi, udhëzim, skeda, formate, dokumente, artikuj për gazeta muri, përmbledhje.</i> • Shkruan shkrime vlerësuese të tipit argumentues • Shkruan shkrime të ndryshme sipas modeleve që i kërkojnë, si: <i>porosi, udhëzime, skeda, formate, dokumente, artikuj për gazeta muri, ese, përmbledhje, shkrime përshkruese a krijuese etj.</i> • Shkruan duke mbajtur qëndrime dhe duke bërë vlerësime përmes argumenteve.
<p>2. Të shkruarit për nevoja vetjake</p> <p>5 orë</p>	<p>☞ Forma të tilla të shkruarit, si: <i>letrat formale dhe personale, shënime, ditar etj.</i> <i>-tregim</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të zhvillojë stilin e tij vetjak të të shkruarit nëpërmjet përdorimit të shenjave dhe të strukturave të caktuara e standardeve të gjuhës. • Të shkruajë duke përdorur 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkruan duke zhvilluar në vazhdimësi stilin e vet. ▪ Shkrime personale, si: <i>letra, shënime, njoftime, ditar etj.</i> ▪ Mban shënime rreth përvojave të veta, si dhe

	<p>-përshkrim, -poezi, -shkrimi i lirë.</p>	<p>imagjinatën e tij.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë shkrime personale, si: <i>urime, shënime, njoftime, ditare, poezi, ese etj.</i> • Të përshkruajë përvoja vetjake, si dhe veprimtari të kryera në grup. • Të shkruajë në mënyrë estetike me ndjenjë dhe me imagjinatë. 	<p>të veprimtarive të kryera në grup.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkruan shkrime personale, si: <i>urime, shënime, njoftime, ditare, poezi, ese etj.</i> ▪ Përshkruan përvoja vetjake, si dhe veprimtari të kryera në grup. ▪ Shkruan me estetikë.
<p>3. Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë</p> <p>5 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Histori të reja nga bota, ☞ Shkrime shkencore, ☞ Skeda vëzhgimesh, ☞ Pyetësorë, ☞ Shënime udhëtimi, ☞ Shkrime për hapësira reale dhe joreale të shfaqura në TV, video, radio etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë duke përdorur imagjinatën e tij. • Të përshkruajë heronjtë e tij imagjinarë. • Të argumentojë rreth figurave të tilla, si: <i>alienët, dinozaurët, dukuritë natyrore dhe zbulimet e shkencës e të teknikës.</i> • Të parashikojë zgjidhje me shkrim. • Të gjejë mbyllje tregimesh sipas imagjinatës së tij. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkruan me ndjenjë e imagjinatë. ▪ Përshkruan me hollësi heronj të vërtetë dhe imagjinarë. ▪ Përshkruan dukuri të natyrës. ▪ Sjell në shkrim argumentime rreth imagjinatës së shfaqur. ▪ Përshkruan me imagjinatë personazhe, ngjarje, dukuri të natyrës dhe zbulime të reja. ▪ Shkruan për parashikime dhe zgjidhje të mundshme. ▪ Shkruan thjesht rreth gjetjeve të reja në shkencë apo në fushatë tjera të interesave. ▪ Bën mbyllje ndryshe të tregimeve sipas imagjinatës.
<p>4. Njohuri rreth gjuhës</p> <p>2 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Terminologji gjuhësore, si: <ul style="list-style-type: none"> - Titulli, - Paragrafi, - Mbiemrat, ndajfoljet, lidhëzat, ☞ Struktura e fjalisë, 	<ul style="list-style-type: none"> • Të respektojë kërkesat gjuhësore sipas llojit të modelit të shkrimit. • Të respektojë paragrafin si kërkesë të rëndësishme në shkrime të tipave të ndryshëm. • Të respektojë shenjat e pikësimit • Të qortojë shkrimin e vet dhe të 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkruan sipas modelit të kërkuar. ▪ Respekton paragrafin gjatë shkrimeve të tipave të ndryshëm. ▪ Përdor me saktësi shenjat e pikësimit. ▪ Qorton variantin e parë të shkrimit të tij dhe të shokëve.

	☞ Shenjat e pikësimit, ☞ Hyrja, zhvillimi, mbyllja	shokut.	
--	--	---------	--

LINJA 4. Njohuri rreth gjuhës dhe sistemit të saj gramatikor

Nënlinjat	Përmbajtja	Objektivat	Arritje e pritshme
Sintaksë 21 orë	A. Funkcionet gramatikore ☞ Grupi i kryefjalës, ☞ Përcaktori, mënyrat e shprehjes, ☞ Kallzuesori i kryefjalës, ☞ Kundrinori i drejtë dhe i zhdrejtë, ☞ Rethanori i vendit dhe i kohës, ☞ Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit, ☞ Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë, ☞ Fjalitë e thjeshtë dhe e përbëra, ☞ Fjalitë me bashkërenditje dhe nënrenditje, ☞ Fjalitë me bashkërenditje.	<ul style="list-style-type: none"> • Të dallojë funksionet gramatikore të fjalëve. • Të përcaktojë mënyrat e shprehjes së përcaktorit. • Të dallojë kallzuesorin dhe llojet e tij. • Të gjejë dhe të shpjegojë kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë. • Të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e vendit dhe të kohës. • Të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e shkakut e të qëllimit. • Të gjejë dhe të shpjegojë rrethanorin e mënyrës e të sasisë. • Të njohë fjalitë e thjeshta dhe të përbëra. • Të njohë fjalitë me bashkërenditje dhe nënrenditje. • Të grupojë fjalitë me bashkërenditje. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallon funksionet e fjalëve dhe të grupeve të fjalëve që marrin pjesë në formimin e fjalisë. ▪ Përcakton mënyrat e shprehjes së përcaktorit. • Dallon kallzuesorin dhe llojet e tij. ▪ Gjen dhe shpjegon kundrinorin e drejtë dhe të zhdrejtë. ▪ Gjen dhe shpjegon rrethanorin e vendit dhe të kohës. ▪ Gjen dhe shpjegon rrethanorin e shkakut dhe të qëllimit. ▪ Gjen dhe shpjegon rrethanorin e mënyrës dhe të sasisë. ▪ Dallon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra ▪ Përdor të gjitha llojet e rrethanorëve. ▪ Dallon fjalitë e thjeshta nga fjalitë e përbëra. ▪ Dallon fjalitë e përbëra me bashkërenditje nga fjalitë e përbëra me nënrenditje.

<p>Morfologji</p> <p>21 orë</p>	<p>Klasat e fjalëve Klasifikimi, të ndryshueshme dhe të pandryshueshme.</p> <p>Emri Lakimi, gjinia, numri (në vijim).</p> <p><i>Përemri dhe llojet e tij</i></p> <p>Mbiemri Përshtatja me emrin në gjini, numër e rasë. Shkallët e mbiemrit</p> <p>Folja Forma veprorë e joveprorë. Zgjedhimi i foljes.</p> <p><i>Grupi foljor</i></p> <p><i>Mënyrat e foljes</i> Mënyra dëftore, kohët.</p> <p>Mënyra lidhore, kohët.</p> <p>Mënyra kushtore, kohët.</p> <p>Mënyra habitore, kohët.</p> <p>Mënyra dëshirore, kohët</p> <p>ëremri vektor Trajtat e shkurtra dhe të bashkuara</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë klasat e fjalëve. • Të klasifikojë fjalët në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. • Të analizojë emrin në kategoritë e tij gramatikore: gjini, numër, rasë, lakim, formim etj. • Të dallojë dhe të analizojë përemrat. • Të dallojë mbiemrin dhe veçoritë e tij gramatikore. • Të dallojë shkallët e mbiemrit. • Të analizojë foljen. • Të zgjedhë foljen në mënyrat dhe kohët e saj. • Të dallojë mënyrat e foljes. • Të zgjedhë foljet në mënyrën dëftore dhe kohët e saj. • Të zgjedhë foljen në mënyrën lidhore dhe kohët e saj. • Të zgjedhë foljen në mënyrën kushtore dhe kohët e saj. • Të zgjedhë foljen në mënyrën habitore dhe kohët e saj. • Të zgjedhë foljen në mënyrën dëshirore dhe kohët e saj. • Të analizojë përemrin vektor. • Të dallojë dhe të analizojë trajtat e shkurtra dhe trajtat e bashkuara të përemrit vektor. • Të analizojë përemrin pronor pronor, si dhe veçoritë e tij gramatikore. • Të dallojë dhe klasifikojë lidhëzat sipas llojeve grupimeveve 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njeh klasat e fjalëve. ▪ Klasifikon fjalët në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. ▪ Analizon emrin në kategoritë e tij gramatikore: gjini, numër, rasë, lakim, formim etj. ▪ Dallon përemrat, llojet dhe veçoritë e tyre gramatikore. ▪ Dallon mbiemrin dhe veçoritë e tij gramatikore. ▪ Dallon shkallët e mbiemrit. ▪ Analizon foljen ▪ Zgjedhon foljen në mënyrat dhe kohët e saj. ▪ Dallon mënyrat e foljes. ▪ Zgjedhon foljet në mënyrën dëftore dhe kohët e saj. ▪ Zgjedhon foljen në mënyrën lidhore dhe kohët e saj. ▪ Zgjedhon foljen në mënyrën kushtore dhe kohët e saj. ▪ Zgjedhon foljen në mënyrën habitore dhe kohët e saj. ▪ Zgjedhon foljen në mënyrën dëshirore dhe kohët e saj. ▪ Të analizojë përemrin vektor dhe ▪ Të bashkojë dhe analizojë trajtat e shkurtra të përemrit vektor me trajtat e bashkuara ▪ Të analizojë përemrin pronor pronor, si
---------------------------------	--	---	---

<p>Leksikologji</p> <p>6 orë</p>	<p>Fjalëformim</p> <ul style="list-style-type: none"> ☞ Fjala dhe përbërësit e saj. ☞ Fjalët e prejardhura, të përbëra, të përngjitura. <p>Homonimet</p> <ul style="list-style-type: none"> ☞ Fusha leksikore ☞ Familja e fjalëve ☞ Sinonimet dhe antonimet 	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizojë fjalën sipas përbërësve të saj. • Të dallojë parashtesat dhe prapashtesat dhe të krijojë fjalë të prejardhura prej tyre. • Të krijojë fjalë të përbëra. • Të gjejë fjalë të përngjitura dhe të dallojë pjesët përbërëse • Të njohë fushat semantike të fjalëve. • Të dallojë kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm. • Të krijojë familje fjalësh. • Të gjejë e të dallojë fjalë sinonime dhe antonime. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Analizon fjalën sipas përbërësve të saj. ▪ Dallon parashtesat e prapashtesat dhe krijon fjalë të prejardhura prej tyre. ▪ Krijon fjalë të përbëra. ▪ Gjen fjalë të përngjitura dhe dallon pjesët përbërëse. ▪ Njih fushat semantike të fjalëve. ▪ Dallon kuptimin e parë të fjalëve dhe kuptimin e figurshëm. ▪ Krijon familje fjalësh. ▪ Gjen e dallon fjalë sinonime dhe antonime.
<p>Kulturë e gjuhës</p> <p>3 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Fjalorët ☞ Dialektet e gjuhës shqipe ☞ Gjuha standarde shqipe 	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë dhe të përdorë fjalorët për interesa mësimore. • Të njohë dialektet e gjuhës shqipe dhe disa veçori të tyre. • Të dallojë fjalën shqipe nga fjala e huaj. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përdor fjalorët për interesa mësimore. ▪ Njih dialektet e gjuhës shqipe dhe disa veçori të tyre. ▪ Dallon fjalën shqipe nga fjala e huaj.

<p>Drejshqiptim, drejtshkrim, pikësim</p> <p>9 orë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund dhe në trup të fjalës. ☞ Drejtshkrimi i bashkëtingëlloreve <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> para dhe pas zanoreve. ☞ Sh-, zh-, ç- nistore ☞ S-, z- nistore ☞ Shkrimi i j-së ☞ Shkrimi i bashkëtingëllores <i>h</i> ☞ Fjalët me rr ☞ J-ja në trup dhe në fund të fjalës ☞ Grupet e bashkëtingëlloreve <i>mb, ng, nd, ngj</i> ☞ Takime bashkëtingëlloresh: <i>d, t, s, z, x</i> me <i>h</i>; <i>g, n</i> me <i>j</i>. ☞ Takimi i dy shkronjave të njëjta, të tipit: <i>alkool</i> etj. ☞ Drejtshkrimi i fjalëve të huaja ☞ Përodrimi i dy pikave, i thonjzave dhe kllapave. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë drejt bashkëtingëlloret e zëshme në <i>fund</i> dhe në <i>trup</i> të fjalës. • Të shkruajë drejt fjalët me bashkëtingëlloret <i>b, d, dh, g, gj, v, x, xh, z, zh</i> para dhe pas zanoreve. • Të shkruajë drejt <i>sh-, zh-, ç-</i> nistore. • Të shkruajë drejt <i>s-, z-</i> nistore. • Të shkruajë drejt <i>j-në</i>. • Të shkruajë drejt bashkëtingëlloren <i>h</i>. • Të shkruajë drejt fjalët me <i>rr</i>. • Të shkruajë drejt <i>j-në</i> në trup dhe në fund të fjalës. • Të shkruajë drejt grupet e bashkëtingëlloreve <i>mb, ng, nd, ngj</i>. • Të shkruajë drejt takimet e bashkëtingëlloresh: <i>d,t,s, z, x</i> me <i>h</i>; <i>g, n</i> me <i>j</i>. • Të shkruajë drejt takimet e dy shkronjave të njëjta fjalë të tilla, si: <i>alkool</i> etj. • Të shkruajë drejt fjalët e huaja. • Të përdorë saktë dy pikat, thonjzat dhe kllapat. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkruan drejt bashkëtingëlloret e zëshme në <i>fund</i> dhe në <i>trup</i> të fjalës. ▪ Shkruan drejt fjalët me bashkëtingëlloret <i>b, d, dh, g,gj, v, x, xh, z, zh</i> para dhe pas zanoreve. ▪ Shkruan drejt <i>sh-, zh-, ç-</i> nistore. ▪ Shkruan drejt <i>s-, z-</i> nistore. ▪ Shkruan drejt bashkëtingëlloren <i>h</i>. ▪ Shkruan drejt fjalët me <i>rr</i>. ▪ Shkruan drejt <i>j-në</i> në trup dhe në fund të fjalës. ▪ Shkruan drejt grupet e bashkëtingëlloreve <i>mb, ng, nd, ngj</i>. ▪ Shkruan drejt takimet e bashkëtingëlloreve: <i>d, t, s, z, x</i> me <i>h</i>; <i>g, n</i> me <i>j</i>. ▪ Shkruan drejt takimin e dy shkronjave të njëjta. ▪ Shkruan drejt fjalët e huaja. ▪ Përdor saktë dy pikat, thonjzat dhe kllapat.
--	--	--	---

UDHËZIME METODOLOGJIKE

1. PARIME DHE KRITERE

A. Parime të përgjithshme

Mësimi i gjuhës shqipe në klasën e shtatë:

- të ruajë dhe të respektojë karakterin kombëtar.
- të ndihmojë në formimin e përgjithshëm intelektual të çdo individi.
- të ndihmojë në krijimin e marrëdhënieve humane në jetën e përditshme.
- të pasqyrojë përmasat e sotme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

B. Parime shkencore

- Mësimi i gjuhës amtare të mbështetet në modelet më të mira të fjalës së dëgjuar, të folur, të lexuar e të shkruar të gjuhës që zhvillohet në procesin e vet të gjallë.
- Mësimi i gjuhës amtare të përcjellë zhvillimet e reja të gjuhës dhe të ligjeve të zhvillimit të saj të brendshëm e të jashtëm.
- Njohuritë për sistemin gramatikor të gjuhës shqipe të jenë të qarta, pa mbingarkesë.
- Të respektohet parimi i përfaqësimit të niveleve gjuhësore sipas specifikave që kanë.
- Parimi morfosintaksor të fillojë të respektohet atëherë kur nxënësit kanë njohje të mira për klasat e fjalëve dhe funksionet e tyre sintaksore.

C. Parime didaktike

- Mësimi i gjuhës shqipe përmes programeve dhe teksteve përkatëse të respektojë parimin e integritetit të gjuhës me leximin letrar.
- Në qendër të mësimin të gjuhës shqipe të qëndrojë parimi i zhvillimit të mendimit kritik gjatë të lexuarit e të shkruarit.
- Mësimi i gjuhës shqipe të jetë në qendër të zhvillimit dhe të përdorimit të metodave të reja të didaktikës bashkëkohore.
- Mësimi i gjuhës shqipe të zhvillohet në mënyrë të tillë, që ta shohë nxënësin në qendër të procesit mësimor dhe t'i lejojë atij të drejta të plota për pjesëmarrje me përvojat jetësore që zotëron.
- Mësimi i gjuhës shqipe kërkon që mësuesi të shpalsë metoda dhe materiale mësimore të gjetura, të mbështetura në literaturë apo të krijuara prej tij për qëllime të rëndësishme të mësimin e të përvetësimit të gjuhës amtare në shkollë.

II. UDHËZIME PËR PËRFAQËSIMIN E PJESËVE LETRARE DHE JOLETRARE

Programi i gjuhës shqipe, klasa 7, në fushën e të lexuarit parashtron:

a- Përfshirjen e pjesëve letrare që mbulojnë:

- Folklorin;
- Letërsinë shqiptare;
- Letërsinë botërore (të kohërave të ndryshme).

b- Forma pune që do të përdoren gjatë orëve të leximit:

- Lexim dhe analizë e teksti;
- Lexime jashtë klase;
- Recitime, dramatizime;
- Shkrime të tipit ese me karakter letrar;
- Lexime jashtë klase dhe punë me shkrim rreth tyre (në formën e një referati të thjeshtë).

c- Për cilësinë e të lexuarit

- Të përmirësohet cilësia, kuptimësia dhe shpejtësia e të lexuarit.
- Nxënësit të lexojnë me ndjenjë.
- Bisedat dhe leximet jashtë klase të orientohen dhe të zgjidhen nga vetë shkolla dhe mësuesit.
- Nxënësit të lexojnë deri në 800 faqe letërsi artistike jashtëshkollore brenda vitit shkollor.
- Të bëhet nga nxënësi plani i pjesës.
- Të analizohen figura personazhesh.
- Nxënësit të dallojnë disa nga mjetet e figurat bazë: metaforën, epitetin, hiperbolën, elemente të thjeshta të vargëzimit nga teoria e letërsisë.
- Ushtrime dhe detyra me shkrim të tipit: shkrim i lirë, ese etj., të shoqërojnë orët e mësimi ku të shkrihen e të ndërthuren shprehitë komunikuese të të folurit, të lexuarit dhe të të shkruarit.

III. INTEGRIMI

- Programi i gjuhës shqipe të pasyrohet në tekst në mënyrë të integruar.
- Lidhja dhe integrimi i programit të kësaj lënde me shumë komponentë të lëndëve të tjera që përfshin plani mësimor i klasës VII, i jep kësaj disipline më shumë frymëmarrje dhe zhvillim.
- Lidhjet të vendosen që në hapat e parë kur hartohet teksti, dhe, më pas, të vijojnë edhe gjatë mësimdhënies.
- Integrimi apo bashkëveprimi i vazhdueshëm i shprehive bazë komunikuese është aspekt i rëndësishëm.
- Asnjëherë nuk mund të bëhen veprimtari të tilla të pastra, si: vetëm lexim, vetëm të folur apo vetëm të shkruar. Të tëra këto rrjedhin nga njëra-tjetra dhe zhvillohen së bashku.
- Një lidhje e fortë ndërmjet këtyre shprehive forcon cilësinë e të nxënit të nxënësve.

VLERËSIMI

- * Vlerësimi i nxënësve është një nga çastet më të rëndësishme të mësimit të gjuhës shqipe në shkollë.
- * Njohja, përshtatja dhe përdorimi i formave të reja të vlerësimit është një kërkesë e cila të jetë e vazhdueshme dhe të pasurohet vazhdimisht me forma pune të frytshme.
- * Puna me standardet të mundësojnë për një përmbajtje cilësore të kurrikulit shkollor.
- * Praktika e përdorimit të testit mësues është një tjetër formë, e cila tashmë ka një kuptim të qartë si nga mësuesi, edhe nga nxënësit.
- * Vlerësimi në mësimin e gjuhës shqipe të kalojë përmes komponentëve të mëposhtëm:
 - Vlerësimi përmes standardeve të arritjes;*
 - Vlerësimi i vazhdueshëm i nxënësve;*
 - Vlerësimi diagnostikues;*
 - Vlerësimi përmbledhës;*
 - Vlerësimi i punëve me shkrim;*
 - Vlerësimi i programit mësues.*

Vlerësimi i punëve me shkrim është një mjet shumë i rëndësishëm i njohjes së aftësive gjuhësore të nxënësve. Njohja e këtij niveli, tashmë, nuk mund të bëhet vetëm me rrugët praktike e tradicionalisht të njohura, si: qortimet nga mësuesi. Praktikën e reja sot orientojnë vendosjen e kriterëve dhe të standardeve të përshtatshme dhe të arritshme nga nxënësit. Kështu, duhen kërkuar forma të larmishme vlerësimi, të cilat të pasqyrojnë nivelin real të arritjeve të nxënësve për marrjen e masave për përmirësimin e tij.

Shënimet e mësuesit janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e punëve me shkrim të nxënësve.

Vlerësimi që nxënësit mund t'i bëjnë njëri-tjetrit, është një tjetër formë e rëndësishme që ndihmon mbarëvajtjen e punës në këtë drejtim.

Hartimi i kriterëve të caktuara për vlerësimin e esëve mundëson vlerësimin real të tyre.

KRITERE PËR HARTIMIN E TEKSTIT GJUHA SHQIPE PËR KLASËN E SHTATË TË ARSIMIT TË DETYRUAR

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

Gjuha shqipe ka qenë dhe vazhdon të jetë teksti dhe instrumenti më efektiv i procesit mësimor në shkollën tonë.

Për këtë arsye, teksti i gjuhës shqipe duhet të udhëhiqet nga parime në trajtimet konceptuale dhe në formën e paraqitjes.

Për herë të parë teksti “Gjuha shqipe 7” do të jetë një tekst i përbashkët brenda të cilit do të përshihen leximi letrar dhe gjuha shqipe, duke respektuar programin e ofruar për këtë qëllim.

Për hartimin e tekstit “Gjuha shqipe 7” kërkohet të realizohen dhe respektohen parimet dhe kriteret e mëposhtme:

- të respektojë parimin e integritetit mes fushave që e përbëjnë atë: *të folurit të lexuarit të shkruarit* dhe njohuri bazë nga fusha e sistemit gjuhësor të shqipes, si dhe mes fushave të tjera të dijeve, të tilla si: historia, gjeografia, art etj.
- Të bëhet jo vetëm respektimi i parimit linear të vendosjes së temave në mënyrën se si janë paraqitur në program, por vendosjen e tyre, atje ku qëndrojnë dhe shërbejnë më mirë.
- Autorët janë të lirë të vendosin temat atje ku ato mundësojnë përshtatje me qëllimet dhe objektivat mësimore dhe kombinimin e tyre.
- Për të realizuar integrimin, është e nevojshme që teksti të prezantohet me njësi mësimore dhe me linja të caktuara që realizojnë objektiva dhe qëllime të larmishme mësimore.
- Parimi tematik mundëson realizimin e integruar të këtij programi.
- Aparati pedagogjik i çdo mësimi duhet të shoqërohet me rubrikat të pasura të cilat pasyrojnë integrimin, duke shmangur nga teksti modelin e aparateve pedagogjike që kanë pamjen e një grupi pyetjesh të renditura njëra pas tjetrës dhe të ndara prej njëra- tjetrës.
- Rimarrja si një parim didaktik duhet të jetë pjesë e mësimëve që do të përbëjnë këtë tekst, me qëllim lidhjen dhe përforcimin e shprehive letrare dhe gjuhësore.
- Kërkohet që teksti i “Gjuha shqipe 7” të jetë një tekst, i cili zhvendos veprimtarinë e mësuesit gjatë mësimdhënies, nga një mësimdhënie me në qendër mësuesin, në një mësimdhënie me në qendër nxënësin.
- Kërkohet, që përmes këtij teksti dhe ushtrimeve që do ta përbëjnë atë, ta kalojmë mësimdhënien nga një mësimdhënie riprodhuese, në një mësimdhënie ku nxënësi *kërkon, gjen, zbulon, zgjidh, analizon etj.*
- Planifikimi i veprimtarive mësimore të tilla *si të lexuari, të folurit, të shkruarit*, duhet të jenë pjesë përbërëse e këtij teksti dhe e çdo ore mësimi, si në pjesën teorike të temave të veçanta, ashtu edhe në pjesën praktike, si në temat nga fusha e letërsisë, ashtu edhe në temat nga fusha e gjuhës shqipe.
- Punët me shkrim të tipit *ese shkrim i lirë përshkrim, portret apo modele të tjera të shkruarit*, kërkohet të jenë pjesë përbërëse e çdo ore mësimore, veprimtari këto që i përfshijnë nxënësit në aktivitete të gjera gjithëpërfshirëse, kërkimore dhe aplikative.
- Kërkesa për punë me shkrim për çdo temë mësimi në aparatet pedagogjike të tyre, nuk duhet të varet apo plotësohet nga orët e veçanta të planifikuara për to në program dhe që lidhen me modelimin e shkrimit.

- Ushtrime dhe forma pune që lidhen me mësimdhënien ndërvepruese duhet të jenë të dukshme në strukturën e aparatit pedagogjik të këtij teksti.
- Për tekstin “Gjuha shqipe 7” kërkohet të bëhet kujdes në respektimin e raporteve midis pjesës teorike dhe asaj praktike të tij, të cilat duhet të respektojnë: 50%-50%, por edhe më të mira në favor të pjesës aplikative.
- Aparatet pedagogjike të këtij teksti të pasyrojnë veprimatri që nxisin zhvillimin e mendimit kritik të nxënësve përmes teknikave dhe startegjive që e mundësojnë këtë gjë.
- Kërkohet që teksti të shoqërohet me *tabela, diagrama, grafike, foto dhe skica* të tjera, kur janë të nevojshme dhe të mos përfaqësohet vetëm nga teksti i shkruar.
- Ushtrimet që do të shoqërojnë mësimet në tekst duhet të përfaqësojnë dhe renditen sipas shkallëve të Taksonomisë së Blumit, nga njohja deri tek vlerësimi, me synim rritjen e cilësisë së të nxënësve deri në nivelin e analizës vlerësimit dhe reflektimit.
- Mësimet që do të zhvillohen në tekstin “Gjuha shqipe 7” kërkohet të kenë paraqitje të lexueshme, didaktikisht dhe gjuhësisht.
- Kërkohet të bëhet kujdes në pikpamje të mbingarkesës mësimore. Thjeshtimi në terma dhe në tekst, është një kërkesë tjetër që për hartimin e tekstit.
- Kërkohet që teksti të mos ketë pamjen e leksioneve të një niveli më të lartë, se sa ai i shkollës së mesme. Për këtë duhen marrë në konsideratë aftësitë përvetësuese nga ana e nxënësve dhe ngarkesa shkollore vjetore dhe ndërlëndore.
- Teksti gjuha shqipe 6 kërkon që në pikpamje të zgjedhjes së pjesëve të leximit të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqiptare dhe ajo botërore siç raporteve të rekomanduara në program.
- Çdo mësim do të ketë rreth 3 faqe në të cilat do të përfshihet njohuritë dhe konceptet si dhe aparatit pedagogjik.
- Pjest e leximit të cilat do të jetë të gjata është mirë të ndahen në pjesë.
- Njësitë mësimore tematike në rastet kur do të punohet mbi bazën e këtij parimi mund të ndërtohen duke përfshirë të gjitha linjat që e përbëjnë programin brenda një njësie por edhe disa prej tyre.
- Teksti “Gjuha shqipe 7 “ do të jetë një tekst deri në 310 faqe A4.
- Teksti “Gjuha shqipe 7” kërkohet të jetë një tekst me jo më pak se dy ngjyra.
- Formatit të jetë: 260 x 200 mm.